

Ardita HAJDARI-BUQINCA

**JETA DHE VEPRIMTARIA E DËSHMORES FATIME
HETEMI**

Dalja në skenë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës pati jehonë në gjithë Kosovën. Jehona e saj arriti në Bistricë edhe në familjen e heroit Kadri Bistrica dhe mësuesit Zeqir Hetemi, bijë e të cilit ishte Fatime Hetemi, për të cilën është trajtuar ky punim. Bistrica e Shalës së Bajgorës gjendet rreth 20km në juglindje të Leposaviqit, një fshat kodrinor, afër lumit me të njëjtin emër. Ky fshat gjatë të kaluarës historike ka pësuar shumë nga sunduesit e ndryshëm, e sidomos nga ai serb.¹ Vetëm gjatë vitit 1999 fshati kishte 27 shtëpi me rreth 280 banorë shqiptarë. Nga lufta e viteve 1998-1999, nga forcat ushtarake dhe paramilitare serbe janë djegur të gjitha shtëpitë e fshatit, shkolla, ambulanca dhe dyqanet dhe janë vrarë 9 banorë shqiptarë.² Fatimja u rrit në një familje atdhetare dhe u edukua në të njëjtën frymë.³ Stërmbesë e heroit Kadri Bistrica⁴, i vrarë gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe vajza e mësuesit Zeqir Hetemi. Fatime Hetemi u lind më

¹ Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës, Vëllimi 8, Mitrovica, Zveçani, Leposaviqi dhe Zubin Potoku, “Shkrola”, Prishtinë, 2004, 182, 183.

² Po aty, 182, 183.

³ Suzana Jahollari & Kujtim Boriçi, Oficeret shqiptare në rrjedhën e historisë (*Arkiva, personalitete dhe kujtime*), *Pjesa e dytë*, Tiranë, 2020, 535.

⁴ Kadri Bistrica (vetë i treti, me Rexhepin e me Rifatin) u vra më 15 tetor të vitit 1941, në një përleshje përballë batalionit çetnik në krye me Tomash Gjericën te Ura e Vuçës afër Sllatinës; Bajram Kurti, Gjaku i lirisë 7-8, Prizren, 2005, 290; Bedri Tahiri, Drenica një shekull trimërie, Prishtinë, 2005, 118.

18 dhjetor të vitit 1977 në fshatin Bistricë.⁵

Fatimja njihej për karakter inteligjent për moshën e saj. Përveç guximit për t'u angazhuar në një kryengritje të armatosur, njihej për shkathtësi, vendosmëri por edhe lexim dhe kureshtje për edukim. Ishte ndër nxënëset më të dalluara të shkollës, por nuk kishte arritur të vazhdojë shkollimin. Në mëngjesin e 14 korrikut të vitit 1993 forcat policore e kishin rrethuar dhe bastisur shtëpinë e prindërve të saj me pretekstin e posedimit të armëve ilegale. Babai i Fatimes, Zeqiri dhe dy djemtë e tij, Behxheti dhe Dritoni, me këtë rast ishin torturuar⁶ dhe ishin arrestuar.⁷

Dalja publike e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës mobilizoi edhe vullnetarët shqiptarë në Shalën e Bajgorës.⁸ Fatimja, ishte njëra ndër vajzat e para të kësaj ane, që kishte shprehur gatishmërinë për mobilizim të armatosur. Ishte ndër vajzat e Kosovës që e gjykonin të arsyeshme të luftonin për t'u çliruar. E nxitur edhe nga dhuna policore ndaj familjes së saj, nga pamundësia për edukim në një kohë të masave të dhunshme, nga vrasjet e bashkëkombësve dhe mohimi i të drejtave elementare njerëzore për ekzistencë.⁹ Të rinjtë dhe të rejtat që iu bashkëngjitën Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës luftuan për mbrojtjen e identitetit dhe dinjitetit të familjeve të tyre dhe të popullit shqiptar nga represioni ushtarako-policor i Serbisë. Në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Drenicë tanimë ishin angazhuar krah Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës luftëtarët Xhevë Krasniqi-Lladrovci, Sanije Geci-Sandokani, Antigone Fazliu, Luljetë Shala e shumë luftëtarë të tjera.¹⁰ Për t'iu bashkuar Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Fatimja e shoqëruar nga i vëllai Bashkimi, ishte nisur për në fshatin Likoc, ku gjendej Shtabi i Përgjithshëm. Ndërkohë në Likoc, Fatimja u takua me Fehmi Lladrovcin dhe me bashkëshorten e tij Xhevë

⁵ Feniksët e lirisë, Dëshmorët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Monografi, f. 43; Suzana Jahollari & Kujtim Boriçi, Oficeret shqiptare..., 535; Bedri Tahiri, Flakadanët e lirisë, 104; Bajram Kurti, Gjaku i lirisë, 290.

⁶ Bajram Kurti, Gjaku i lirisë 7-8, Prizren, 2005, 293.

⁷ Driton Hetemi, Dokumentar, Radio Kosova, (autore: Sabrie S. Haxhiu), 19.06.2019.

⁸ Suzana Jahollari & Kujtim Boriçi, Oficeret shqiptare..., 536.

⁹ Bajram Kurti, Gjaku i lirisë 7-8, Prizren, 2005, 293, 294; Bedri Tahiri, Flakadanët e lirisë, Prishtinë, 2004, 103.

¹⁰ Feniksët e lirisë, Dëshmorët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Libri i tretë, SHVLUÇK, Prishtinë, 2003, 266.

Krasniqi-Lladrovci.¹¹ Në muajin maj të vitit 1998 në moshën 20-vjeçare edhe Fatimja iu bashkëngjitet radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Xheva dhe Fatimja kishin një miqësi të veçantë përveç solidaritetit, që i përcolli deri në momentin e rënies së tyre në betejë. Ideali i tyre mund të shihet si motiv i grave shqiptare për pjesëmarrje të barabartë në luftëra të armatosura që tanimë kishin analogji në Drenicë.

Me zhvendosjen e Fehmi Lladrovci në brezin e fshatrave të Qyqavicës dhe vendosjen në fshatin e tij të lindjes, Shkabë (ish-Gllanasellë), natën e 23 e 24 majit të vitit 1998, bashkë me Xhevën vendoset edhe Fatimja dhe bashkëluftëtarë të tjerë. Së këndejmi, Fatimja, krahë për krahë me Xhevën, ishte pjesëtare e luftimeve, që do të bëheshin në fshatrat që më vonë u përfshinë nën komandën e Fehmi Lladrovci, në Batalionin e Parë të Brigadës 114.¹² Në shtator të vitit 1998, forcat serbe filluan ofensivë të madhe që synim kishin kryesisht sulmet në të gjitha fshatrat e Drenicës, ku strehoheshin dhe luftonin brigadat e UÇK-së 113 dhe 114, të Zonës Operative të Drenicës.¹³

Ofensiva e Ushtrisë serbe kishte për qëllim shuarjen e rezistencës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në grykat strategjike të kontrollimit të rrugëve në Drenicë. Me këtë qëllim forcat serbe kishin sulmuar disa fshatra nga Komarani, Glllogoci dhe Skënderaj në drejtim të pozicioneve të Brigadës 114, që vepronte në fshatrat përreth Qyqavicës.¹⁴ Te Shkëmbi i Gradinës së fshatit Shkaba së bashku me Fehmi Lladrovci dhe Xhevën ishte vendosur edhe Fatimja dhe 20 luftëtarë të tjerë.¹⁵ Fehmi Lladroci ishte komandant i pozicioneve luftarake të emëruara si “Shkaba”. Më datë 22 shtator të vitit 1998 në zonën e fshatrave të Qyqavicës u zhvilluan luftime në mes të forcave serbe dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në ofensivën që njihet edhe

¹¹ Suzana Jahollari & Kujtim Boriçi, *Oficeret shqiptare...*, 536; Bajram Kurti, *Gjaku i lirisë 7-8*, 293, 294; Bedri Tahiri, *Flakadanët e Lirisë*, Prishtinë, 2004, 103.

¹² Selman Krasniqi, *Drenica e Epërme dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës*, Monografi, Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, Printing Press, Prishtinë, 2015, 166-167; Hamdi V. Thaçi, *Drenica djep i UÇK-së dhe Batalioni I i Brigadës 114 “Fehmi Lladrovci”*, Prishtinë, 169, 170.

¹³ Selman Krasniqi, *Drenica e Epërme dhe Ushtria Çlirimtare...*, 166-167.

¹⁴ Feniksët e lirisë, *Dëshmorët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës*, Libri i tretë, SHVLUÇK, Prishtinë, 2003, 267.

¹⁵ Hamdi V. Thaçi, *Drenica djep i UÇK-së dhe Batalioni I i Brigadës 114 “Fehmi Lladrovci”*, Prishtinë, Shtëpia botuese “Meshari”, 2017, 482.

si Ofensiva e Shtatorit. Gjatë kësaj ofensive, në fshatin Shkabë u zhvillua beteja më e përgjakshme.¹⁶

Lufta te Gradina (tash Shkëmbi i Qëndresës) që filloi në mëngjesin e 22 shtatorit ishte joproportionale. Forcat serbe sulmonin dhe granatonin me armë të rënda. Gjatë luftimeve Fatimja goditet rënd nga një plumb në kokë ku edhe humb jetën. Për këtë rrëfen ushtari Idriz Karaxha, i cili ishte bashkëluftëtar i Fatimes. Idrizi rrëfen se kur ishte plagosur Fatimja, kishin ardhur Shefqet Morina dhe Gazmend Lladrovci për t'i ardhur në ndihmë. Por tërheqja ishte e pamundur për shkak të plagëve të rënda dhe granatimeve serbe.¹⁷ Rënia e saj në fushë të betejës kishte dëshpëruar pa masë Xhevën, por edhe bashkëluftëtarët e tjerë. Rreth dy orë pas rënies së Fatime Hetemit bien edhe komandant Fehmiu e luftëtarja Xhevë dhe disa luftëtar të tjerë. Pas rënies së tyre bie edhe mbrojtja e Gradinës, ndërsa trupat e tyre tërhiqen dhe varrosen në varrezat e fshatit Shkabë.¹⁸

Pas rënies së tyre lufta vazhdon, kështu rrëfehët Sabit Lladrovci. Ai rrëfen që ushtarët kanë vazhduar luftimet edhe pas rënies së komandantit. Sabiti shton se mbrëmjen e 25 shtatorit është bërë tërheqja e trupave¹⁹ dhe sipas Ferki Karaxhës ditën e nesërme më datën 26 shtator të vitit 1998 është bërë varrimi i luftëtarëve të rënë në këto luftime: Fehmi Lladrovci, Xhevë Krasniqi-Lladrovci, Fatime Hetemit, Shefqet Zekës dhe Hamit Lladrovci.²⁰ Pas rënies së Fehmi Lladrovci, kjo brigadë merr emrin e komandantit Fehmi Lladrovci. Brigada 114 përfshinte viset e Drenicës Lindore, duke filluar nga magjistranja Prishtinë-Pejë, në jug, Komoran-Skënderaj, në perëndim, e në lindje deri në Qyqavicë, dhe disa fshatra përtej Grykës së Gurit të Plakës, Grabofc, Bardh i Madh, Lismir e Hade.²¹ Në vendin e rënies së luftëtares Fatime Hetemi, Xhevë Krasniqi-Lladrovci, komandantit Fehmi Lladrovci e të rënëve të tjerë, bashkëluftëtarët kanë ngritur

¹⁶ Po aty, 214.

¹⁷ Idriz Karaxha, Dokumentar, Radio Kosova, (autore: Sabrie S. Haxhiu), 19.06.2019; Hamdi V. Thaçi, Drenica djep i UÇK-së, 233, 234; Feniksët e lirisë, Dëshmorët e Ushtrisë Çlirimtare..., 267.

¹⁸ Hamdi V. Thaçi, Drenica djep i UÇK-së..., 482.

¹⁹ Sabit Lladrovci, Dokumentar, Radio Kosova, (autore: Sabrie S. Haxhiu), 29.06.2019.

²⁰ Ferki Karaxha, Dokumentar, Radio Kosova, (autore: Sabrie S. Haxhiu), 29.06.2019; Hamdi V. Thaçi, Drenica djep i UÇK-së..., 254.

²¹ Po aty, 172, 175, 210, 232.

Kompleksin memorial të përjetshëm me emrin Kulla e Qëndresës,²² ku edhe sot qëndron si trashëgimi atrocitare e rezistencës së tyre për liri. Për pjesëmarrësit e kësaj beteje, janë ngritur përmendore dhe janë ndarë mirënjohje nga instancat e larta shtetërore.

Pas rënies së dëshmoreve për trimërinë e treguar në luftën për liri, me rastin e 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit, Fatime (Zeqir) Hetemi është dekoruar me Urdhrin Luftëtar i Lirisë “Adem Jashari” nga presidentja e Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga.²³ Më 10 qershor të vitit 2013, me rastin e 28 Nëntorit, festës së flamurit kombëtar, Bashkimi i Intelektualëve Shqiptarë në Zvicër, i kryesuar nga Abas Fejzullahi, ndan mirënjohje për dëshmoren e kombit Fatime Hetemin, që ra heroikisht për lirinë e atdheut dhe e fitoi përjetësinë.²⁴ Pastaj, më 30 dhjetor të vitit 2019 për trimëri dhe sakrificë për lirinë e Kosovës, nga presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, i jepet Urdhri “Hero i Kosovës”.²⁵

Për jetën, sakrificën dhe veprën e dëshmoreve Fatime (Zeqir) Hetemi dhe dëshmoreve tjera të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të rëna në luftën për çlirimin e Kosovës, janë botuar shkrime, janë thurur vargje poetike, u janë kushtuar këngë, por dhe janë ngritur lapidarë si dëshmi e atrocitetit serb por edhe përjetësimit të emrit të tyre për ta shënjuar veprimtarinë dhe rënien e tyre. Për trimërinë, frymëzimin, heroizmin, guximin, vullnetin, entuziazmin, shkathtësinë dhe vendosmërinë e luftëtares Fatime Hetemi për t’u bashkuar në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, janë rrëfyer familjarë, bashkëluftëtarë, kurse disa historianë kanë shkruar disa shkrime për heroinën Fatime Hetemi. Xheva dhe Fatimja si dhe shumë vajza dhe gra shqiptare që luftuan krah Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë dhe mbeten në historiografinë bashkëkohore si heroinat e Republikës së Kosovës. Ishin të vetëdijshme për strategjinë e luftës dhe rëndësisë që kishte pjesëmarrja e grave dhe vajzave. Këto e kishin kuptuar mirë solidarizimin familjar dhe gjinor për qëndresën e përbashkët që tanimë familja Jashari e kishte vendosur si kriter udhërrëfyes për rezistencë vetëflijuese.

²² Feniksët e lirisë, Dëshmorët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Libri i tretë, 268.

²³ Republika e Kosovës-Presidentja, Urdhri Luftëtar i Lirisë “Adem Jashari”, Prishtinë, 28.09.2012.

²⁴ Bashkimi i Intelektualëve Shqiptarë në Zvicër-kryetari Abas Fejzullahi, që ra heroikisht për lirinë e atdheut dhe e fitoi përjetësinë, Zvicër, 10-06-2013.

²⁵ Republika e Kosovës-Presidenti, Urdhri “Hero i Kosovës”, Prishtinë, 30.01.2019.